

POP 5

1

Paralajmërimi i Vangjelit: Në 18 ditët e ardhshme mund të kemi dorëheqje masive nga mbishtetësit e Bashës

2

"Të të... brezhkë", Paloka flet me tone të ashpër: Nëse me mendje mendja që do të vijë një ditë që do të më kërkonin të largohesha nga PD

3

Berisha: SHBA të më kërkojë ndjesë që më shpallin si njeri që nuk e bënë dot i faj

4

Pushtin' dhe çlitorin' në Selinë e PD, komentor' s'ka Rama: Xhyz brenda kanë qenë gjithnjë dy të marrë...

5


Të hetuar më parë për drogë, ja jeta luksoze e 2 Gërmes të biznesmenit që u ekzekutua në Laç

Kronikë

Lezhë/ Dhëndurët shndërruan lokalin e vjehrrit në bazë vrasësish me pagesë! Policia i 'prish' atentatin ndaj Preng Palucës, që i ka shpëtuar 2 atentateve më parë! Shkak, pazaret e drogës

Preng Paluca, 50 vjeç, nga Kamza duhet të jetë një njeri shumë me fat. Një atentat i tretë i bërë gati për t'i marrë jetën, ka dështuar këtë herë falë uniformave blu. Policia e Lezhës ka parandaluar eliminimin e tij, pasi 2 persona ishin bërë gati për ta ekzekutuar me mina, të cilat dyshohen se prodhoheshin në një vend fqinj. Prangosen 3 persona, por shpëtojnë ekzekutuesit (EMRAT).

■ 2 personat që do të kryenin atentatin me mina me telekomandë në Tiranë kanë ndërruar mbiemrat



Preng Paluca, 50 vjeç, nga Kamza duhet të jetë një njeri shumë me fat. Një atentat i tretë i bërë gati për t'i marrë jetën, ka dështuar këtë herë falë uniformave blu. Policia e Lezhës ka parandaluar eliminimin e tij, pasi 2 persona ishin bërë gati për ta ekzekutuar me mina, të cilat dyshohen se prodhoheshin në një vend fqinj. Prangosen 3 persona, por shpëtojnë ekzekutuesit (EMRAT).

Policia e Lezhës, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative, ka mësuar se disa persona po organizonin të kryenin një vrasje, duke përdorur mina me telekomandë dhe armë zjarri. Uniformat blu kanë organizuar operacionin "Mataro", dhe kanë arrestuar në flagrancë 3 persona dhe janë shpallur në kërkim 2 të tjerë.



LEXO EDHE: Bëri drift me makinë dhe postoi videon në rrjete sociale! Në hetim 24-vjeçari në Lezhë! Policia i bllokoi makinën dhe i heq patentën për 2 vite

Të arrestuar janë Mark Lamkja, Nikoll Marku dhe Marie Marku. Të shpallur në kërkim shtetasit Edmir Vlashi i cili më parë ka mbajtur mbiemrin Ndoka dhe Hektor Ndoka, i cili më parë ka mbajtur mbiemrin Sadiku.

Report Tv ka mësuar se përveç 27-vjeçarit, Mark Lamkja, edhe Edmir Vlashi, 31 vjeç, janë dhëndurë të Nikoll dhe Marie Markut, të cilët e shfrytëzonin lokalin e vjehrrit të tyre si bazë për grupin e vrasësve me pagesë. Report Tv ka zbuluar gjithashtu se arsyeja e atentatit të mbetur tashmë në tentativë janë konfliktet e drogës në Belgjikë.

Vihet re se personat e shpallur në kërkim janë pikërisht ata që do të kryenin atentatin në Tiranë, të cilët sipas policisë janë të dyshuar për vepra të tjera të rënda kriminale.


"M. L., 27 vjeç, banues në fshatin Tale, Lezhë, i dënuar më parë në Itali, për veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë" dhe "Armëmbajtja pa leje", N. M., 62 vjeç dhe M. M., 60 vjeçe, të dy banues në lagjen "Varosh", Lezhë. Gjithashtu është bërë shpallja në kërkim e shtetasve E.V., 31 vjeç dhe H.N., 31 vjeç, persona me precedentë të theksuar kriminal dhe rrezikshmëri ta lartë shoqërore, të dyshuar për disa ngjarje të rënda kriminale në fushën e krimeve kundër jetës dhe pronës", thuhet në njoftimin e policisë.

Si do të ndodhte atentati?

Sipas uniformave blu 2 persona Hektor Ndoka dhe Edmir Vlashi, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kishin planifikuar të kryenin një vrasje në qytetin e Tiranës, për shkak të konflikteve të mëparshme në lidhje me prishjen e pazareve të drogës, jashtë shtetit. Si bazë për fshehjen e armatimit që do të përdornin për kryerjen e vrasjes dhe të të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal, kishin shfrytëzuar ambientet e banesës dhe të restorantit të shtetasit Nikoll Marku. Ndërsa Mark Lamkja, dhëndri i shtetasit Nikoll Marku, është kapur me armë zjarri pistoletë, gjatë operacionit, në përjekje për të fshehur provat që u gjetën gjatë kontrollit të Policisë.

Provat e sekuestruara

Policia sekuestroi 2 mina me telekomandë, me lëndë eksplozive C-4, të përgatitura gati për shpërthim, të cilat sipas të dhënave rezultojnë se janë prodhuar në një vend fqinj me Shqipërinë; 88.900 euro të përfituara nga aktiviteti kriminal në fushën e lëndëve narkotike dhe krimeve ndaj personit; 2 armë automatike me shënjestër optike, 2 kallashnikovë, 1 armë automatike model "Scorpions", me silenciator me dy krehra, 1 armë zjarri pistoletë model "Glock", me një krehër me 11 fishekë, fishekë luftarak, kapsolla detonatore, ftil zjarrpërcejllës, 1 armë gjahu, 2 radio marrëse-dhënëse si ato të Policisë, 2 skafandra motori dhe 1 automjet. Armët e sekuestruara do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore në Tiranë, për ekzaminime të mëtejshme, pasi nga informacionet e grumbulluara dyshohet se këto armë janë përdorur edhe në ngjarje të tjera kriminale të ndodhura më parë.



Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:50

Zbulohet shënjestra e atentatit të dështuar! Të dyshuarit kanë ndërruar mbiemrat



Të tjera detaje nga ngjarja e rëndë e Lezhës. Burime nga Policia konfirmojnë se personi që dyshohej se do të ekzekutohej nga Edmir Vlashi dhe Hektor Vlashi është Preng Paluca.

Këtë të fundit bashkë me bashkëshorten, Antonetën, i është bërë atentat pranë shtëpisë në datën 7 gusht në Kamëz, ndërsa mbetën të plagosur. Të arrestuarit nuk kanë deklaruar asgjë para hetuesve. Hektorit dyshohet se ka pasur që më herët konflikte me vëllezërit Paluca në Kamëz. Hektori është shok dhe bashkëpunëtor i Edmirit.

Hektor Sadiku e ka ndërruar mbiemrin e ka bërë Ndoka. Edmir Marku e ka ndërruar mbiemrin e ka bërë Vlashi.



Ora 10:57

2 dhëndurët përfshijnë edhe vjehrrin dhe vjehrrën në grupin e vrasësve me pagesë në Lezhë! Mësohet vendi i BE-së ku u konfliktuan për drogën



Report Tv ka mësuar të tjera detaje në lidhje me përgatitjen për atentatin e parandaluar nga policia e Lezhës nga një grup trafikantësh në Lezhë.

Mësohet se përveç 27-vjeçarit, Mark Lamkja, edhe Edmir Vlashi, 31 vjeç, ishin dhëndurë të Nikoll dhe Marie Markut, të cilët e shfrytëzonin lokalin e vjehrrëve të tyre si bazë për grupin e pagësve me pagesë.

Report Tv ka mësuar gjithashtu se arsyeja e atentatit të mbetur tashmë në tentativë janë konfliktet e drogës në Belgjikë.



K.T/B.K./Shqiptaria.com

TAG: Lezhe kamaz policia e lezhes Nikoll Marku Edmir Vlashi hektor ndoka mark lamkja marie marku

Komento

Komente

Mbiemri:

08/12/2021 18:13

E din shume mire shteti qe kane ndryshu mbiemrin Sepse cdo gje del ne sistem dhe ne dokumente Si e ka pase dhe si e ka. Por nuk duan te kapin asnjë! Dhe kto kushedi ku kane prish balancat dhe skane Pagu leket, se ka me mina vrases me pagese Qe bejne ster vite cdo dite palestere e poligone Dhe pijnje kafe ne bline dhe me makina te fundit Dhe e thojne si me shaka," spo kena hic kohet e fndit " Idea eshte qe te gjithë e dine por asnje sftet, Femrat i krefm leket, policia gjithashtu, Agjentet nuk japin info sepse jane te shitur Ose nen presion sepse nuk i shkon info ne vend, Populli i mbarum i varfer i rrenuar, shëf punen e vet thote larg meje dhe si perfundim kush do i kallioje kto njerez??!!!! Kto e kane kthty si biznes te mirefillte, jep porosi Dhe vazhdo punen kto plera, sipas preferencave, Me keq se neper filma qe i japin foton dhe i cojne Ne boten tjetër!

Përgjigju

Xhiashi:

08/12/2021 15:02

Po si dreqin e ndryshojne mbiemrin keta horra. Duhet vendim gjykate dhe gjykates duhet te verifikojte nese kane precedent penal. Gjykates maskaren

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Si e vlerësoni lëvizjen e Berishës dhe mbështetësve të tij për të shkuar në selinë e PD?

PUSHTIM ÇLIRIM NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Bien gurët e murit rrethues të kalasë së Lezhës, rrezikohen kalimtarët dhe banesat! Insituti i Trashgëmisë Kulturore për Report Tv: Nis restaurimi në 2022

13 Dhjetor, 11:20

Sociale

Moti i keq, stabilizohet situata në Lezhë! 100 ha tokë të përmbytura, niveli i ujit në rënie! Rugëst nacionale të kalueshme pa probleme

13 Dhjetor, 10:54

Kronikë

Atentati i parandaluar në Lezhë ndaj Preng Palucës, gjendet banesa e njërit prej autorëve! Brenda, një pistoletë dhe disa mjete identifikimi

13 Dhjetor, 08:54

Kronikë

Ekzekutimi i biznesmenit në Laç, Report Tv zbulon dëshminë e 22-vjeçarit Lika në polici: Vrasjen e kam bërë unë se djemtë e tij më rrahën! Babai dhe shoku s'kanë lidhje

12 Dhjetor, 12:53

Kronikë

Dyshohen se vranë biznesmenin në Kurbin, arrestohen babë e bir

11 Dhjetor, 16:56

Kronikë

Vrasja e biznesmenit në Lezhë, arrestohen babë e bir! Report Tv siguron foton ekskluzive nga momenti i largimit të autorëve me Benz-in gri pas krimit! Gjendet dhe arma

11 Dhjetor, 10:58